

prill 2017

# gap | memo

POLITIKASH

KOMUNITETE TË  
ORGANIZUARA

## ROLI DHE RËNDËSIA E QYTETARISË AKTIVE



- Angazhimi i qytetarëve në aktivitetet publike
- Vendbanimet me qytetari aktive
- Karakteristikat e përbashkëta të lokaliteteteve të vetëorganizuara

## Hyrje

Gjatë viteve të '90-ta, qytetarët e Kosovës u organizuan mjaft suksesshëm për t'i rezistuar shtypjes dhe për të ndihmuar mbijetesën e popullatës, të cilët diskriminoheshin dhe persekutoheshin në secilën sferë. Në këtë mënyrë, me angazhim vullnetar, u arrit që të organizohej sistemi paralel i edukimit në gjuhën shqipe, shëndetësia, mbrojtja sociale dhe më pas ajo ushtarake. Përveç atyre që jetonin në Kosovë, në këtë organizim ndihmë të madhe dha edhe diaspora.

Por pas vitit 1999, me hyrjen e Kosovës nën administrimin ndërkombëtar dhe me krijimin e institucioneve vetëqeverisëse, kjo frymë e qytetarisë aktive u shua. Arsyet për këtë janë të shumta, duke filluar nga ndihmat e para humanitare të komunitetit ndërkombëtar pas çlirimit të Kosovës, e duke vazhduar pastaj me besimin e tepruar të qytetarëve të Kosovës se institucionet qeverisëse lokale dhe qendrore do të arrijnë të përmbushin të gjitha shërbimet publike, pa qenë nevoja e vazhdimit të vetë-organizimit qytetar.

Megjithatë, ekzistojnë përjashtime. Gjatë punës së Institutit GAP në komuna të ndryshme të Kosovës, kemi identifikuar së paku gjashtë lokalitete të cilat vazhdojnë vetëorganizimin qytetar, duke u angazhuar në çështje të ndryshme publike, nga mirëmbajtja e hapësirave të përbashkëta, ndërtimin e shtëpive për familjet me gjendje të rëndë ekonomike, financimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive, etj.


Ky raport paraqet modelet e iniciativës së banorëve të Korishës dhe Lubinjës së Epërme të Prizrenit, të Smirës dhe Stubllës së Vitisë, Dobërçanit të Gjilanit dhe Koretinit të Kamenicës, të cilët kanë tejkaluar ndasitë partiake dhe etnike dhe kanë krijuar mekanizma për të bërë vendbanimet e tyre më ekologjik, më funksional dhe më të organizuar.

Raporti jep një pasqyrë të aktivizmit të përgjithshëm qytetar, bazuar në një hulumtim të gjerë të Institutit GAP me 1000 respondent në gjithë Kosovën. Në fund, janë dhënë rekomandime se si shembujt e këtyre gjashtë lokaliteteve mund dhe duhet të ndiqen edhe nga lokalitete tjera nëpër Kosovë.

## Angazhimi i qytetarëve në aktivitete publike


Për të pasur një pasqyrë më të qartë të nivelit të organizimit qytetar, Instituti GAP, në muajt e parë të vitit 2017, ka ndërmarr një hulumtim të gjerë me 1000 respondentë në tërë territorin e Kosovës.

Të pyetur nëse në 12 muajt e fundit kanë kryer ndonjë punë vullnetare, 85% e qytetarëve të anketuar kanë deklaruar se nuk janë angazhuar në asnjë punë vullnetare.



**FIGURA 1.** A KENI KRYER NDONJË PUNË VULLNETARE NË KOMUNITET NË 12 MUAJT E FUNDIT?

Një përqindje edhe më e madhe e të anketuarve kanë deklaruar se nuk janë pjesë e asnjë organizate jo qeveritare.



**FIGURA 2.** A JENI PJESË E NDONJË SHOQATE/ORGANIZATE JOQEVERITARE?

Në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale<sup>1</sup>, komunat ndihmojnë në themelimin e këshillave lokale dhe bashkëpunojnë me to për të adresuar çështje të ndryshme që bien në kompetencë të organizimit komunal. Në bazë të kësaj, komunat kanë nxjerrur rregullore komunale dhe në statutet e tyre kanë paraparë mënyrat e themelimit dhe funksionimit të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

Në bazë të hulumtimit të Institutit GAP, del se në nivel të Kosovës, vetëm 38 për qind e qytetarëve janë në dijeni të ekzistimit të këshillave lokale, kurse 44 për qind e të anketuarve nuk ishin fare në dijeni nëse lagjia/fshati i tyre kishte themeluar këtë këshill.




FIGURA 3. A ËSHTË I THEMELUAR KËSHILLI I FSHATIT/LAGJES TUAJ?

Por vetëm rreth 31 për qind e tyre kishin marrë pjesë në zgjedhjen e anëtarëve të këtij këshilli.





FIGURA 4. A KENI MARRË PJESË NË ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KËTIJ KËSHILLI?


<sup>1</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, neni 34. Burimi: <http://bit.ly/1CulaKA> (hapur së fundmi më 10 mars 2017).

Qytetarët gjithashtu u pyetën se sa herë kishin marrë pjesë në ndonjë nga takimet publike të organizuara nga komuna gjatë 12 muajve të fundit. Siç mund të shihet në figurën 5, shumica e të anketuarve (81%) nuk kishin marrë pjesë asnjëherë gjatë 12 muajve të fundit në këto takime, ndërsa 10 për qind kishin marrë pjesë vetëm një herë dhe 7 për qind dy herë e më shumë.



**FIGURA 5.** SA HERË KENI MARRË PJESË NË TAKIMET PUBLIKE TË ORGANIZUARA NGA KOMUNA, NË 12 MUAJT E FUNDIT?

Pjesa më e madhe e qytetarëve të anketuar kanë deklaruar se nuk janë pjesë aktive e organizimeve partiake, por përqindja e atyre që kanë deklaruar se janë pjesë e partive politike është dukshëm më e lartë se sa e atyre që kanë deklaruar se janë pjesë e organizimeve të shoqërisë civile apo që kryejnë punë vullnetare.



**FIGURA 6.** A JENI PJESË AKTIVE E NDONJË PARTIE POLITIKE?

Këto të dhëna tregojnë se qytetarët e Kosovës nuk janë mjaft aktiv në organizime të ndryshme publike dhe pjesa më e madhe e tyre nuk janë të interesuar në punët publike. Por, ekzistojnë disa

përrjashtime, të cilat kemi arritur që t'i identifikojmë gjatë punës tonë në nivel lokal, në vendbanime të ndryshme në Kosovë.

## Vendbanime me qytetari aktive

Instituti GAP ka identifikuar së paku gjashtë fshatra, banorët e të cilave, në bashkëpunim me diasporën dhe bizneset, organizohen për të diskutuar dhe trajtuar tema që kanë të bëjnë me përmirësimin e mjedisit ku jetojnë. Këto fshatra janë: Korisha, Dobërçani, Koretini, Smira, Stublla e Epërme dhe Lubinja e Epërme.

### Korisha

Korisha është fshat me mbi 5,200 banorë<sup>2</sup> në Komunën e Prizrenit. Pas luftës, Korisha mori epitete të ndryshme. U quajt fshati që qeveris veten, meqë nuk pret shumë ndihmën e komunës në projekte madhore që nga furnizimi me ujë e deri te ndërtimi i rrugëve dhe shtëpive.<sup>3</sup> Madje u quajt edhe fshati më ekologjik i Prizrenit, meqë grumbullimi i mbeturinave, mirëmbajtja e hapësirave gjelbëruese dhe pastrimi i vijave të ujit bëhet çdo ditë nga persona të ngarkuar me këto punë.<sup>4</sup> Korisha është një shembull që tregon transformimin e një fshati të shkatërruar në një fshat të mirë organizuar.

I ndodhur jo më larg se pesë kilometra nga qendra e Prizrenit, ky fshat i përngjan një komune në miniaturë. Ka këshillin e fshatit prej 12 anëtarësh të cilët i përkasin partive të ndryshme politike; ka kryetarin e fshatit me mandat pesë vjeçar; ka komisionin për financa; ka xhirollogarinë e vet bankare; dhe ka katër punëtorë të rregullt që kujdesën për mirëmbajtjen e fshatit.

Përderisa këshilli takohet herë pas here për të diskutuar çështjet më rendësi të fshatit, katër punonjësit kanë obligime të rregullta

<sup>2</sup> Sipas të dhënave të regjistrimit të popullsisë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Burimi: <http://bit.ly/2nzioB0>

<sup>3</sup> Tinka Kurti. Korisha – fshati që qeverisë veten. Kallxo.com. Burimi: <http://bit.ly/2mTT8V8>, qasur më 8 mars 2017.

<sup>4</sup> Ferma Ime. Korisha – fshati më ekologjik në rajonin e Prizrenit. Burimi: <http://bit.ly/2mPwkFd>, qasur më 8 mars 2017.

ditore. Detyrat e tyre kanë të bëjë me mirëmbajtjen e fshatit, pastrimin e rrugëve të fshatit, eliminimin e defekteve të kanalizimit, mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit, hapjen e vijave për ujitjen e tokave pjellore, pastrimin e varrezave, hapjen e varreve si dhe inkasimin e mjeteve financiare. Është kjo e fundit që bën të mundur mbushjen e buxhetit të fshatit, prej të cilit paguhen katër punonjësit që punojnë me orar të plotë për gjashtë ditë në javë. Pagat e tyre mujore sillen nga 220 euro deri në 300 euro, përderisa puna e këshillit të fshatit është krejtësisht vullnetare.

Edhe mbushja e buxhetit të fshatit nuk është obligative për 5,000 banorët e fshatit, megjithatë është një parim që respektohet nga shumica e familjeve. Duke ndarë nga tre euro në muaj,<sup>5</sup> fshati me 800 shtëpi krijon një buxhet vjetor prej rreth 30 mijë euro. Përpos se ka një llogari të veçantë bankare, Korisha ka edhe rregulla për të evituar keqpërdorimet e financave. Për këtë është themeluar një komision tre anëtarësh i cili menaxhon buxhetin e fshatit. Sipas rregullave, asnjë transaksion nuk mund të bëhet pa nënshkrimin e tre personave njëkohësisht.



**FOTO 1:** LAPIDARI I DËSHMORËVE DHE PARKU NË FSHATIN KORISHË

<sup>5</sup> Intervistë me Abaz Bobaj, kryetar i fshatit Korishë, më 22 shkurt 2017.

Buxheti i fshatit është i mjaftueshëm jo vetëm për të mbajtur në punë katër punonjës të rregullt, por edhe për të ndihmuar familjet me asistencë sociale në mjekim apo strehim, si dhe për të organizuar aktivitete kulturore për dëshmorët dhe të rënët e luftës. Për këta të fundit, në mes të fshatit është ngritur një lapidar, i cili përveç se bie në sy për nga pastërtia dhe mirëmbajtja, të përkujton rindërtimin e një komuniteti të shkatërruar nga lufta në një komunitet model për nga organizimi dhe vetë-iniciativa.

## Dobërçani

Fshati Dobërçan, i njohur jo zyrtarisht edhe si fshati Miresht, është pjesë e Komunës së Gjilanit dhe ka rreth 2,700 banorë. Që nga përfundimi i luftës, banorët e fshatit janë vetëorganizuar për të trajtuar problemet e shumta të fshatit, si për nga infrastruktura publike, ashtu edhe në organizimin e aktiviteteve kulturore, adresimin e problemeve sociale dhe të banimit, etj. Një ndër aktivitetet e para të pasluftës ka qenë ndërtimi i lapidarit për dëshmorët e fshatit dhe ndërtimi i parkut, i cili është mirëmbajtur gjatë tërë kohës nga banorët e fshatit.<sup>6</sup> Nga kontributet financiare vullnetare të banorëve të këtij fshati në diasporë dhe nga ata që jetojnë në këtë fshat, përveç parkut, është arritur që të rregullohet shtrati i lumit, largimi i mbeturinave, ndërtimi i së paku katër shtëpive për familjet me gjendje të rëndë ekonomike, ndihma financiare për shërim të personave në nevojë, etj. Përgjatë tërë vitit, me këto kontribute, janë angazhuar dy mirëmbajtës të hapësirave publike, të cilët paguhen nga vetë komuniteti. Familjet e këtij fshati paguajnë nga 10 euro në vit, kurse bizneset nga 20 euro. Diaspora kontribuon me 50 franga.



**FOTO 2:** MIRËMBAJTJA E SHTRATIT TË LUMIT NË FSHATIN DOBËRÇAN<sup>7</sup>

<sup>6</sup> Intervistë me Arlind Abdyli, aktivist i shoqatës "17 shkurti". Intervistë e zhvilluar më 7 mars 2017.

<sup>7</sup> Foto e mare nga faqja në facebook, e cila përdoret si formë për organizim dhe promovim të aktiviteteve në fshat:

<https://www.facebook.com/Vetëmbanoretëmireshit/?fref=ts>



Nga shkurti i vitit 2009, diaspora e këtij fshati në Cyrih të Zvicrës është strukturuar në shoqatën “17 shkurti”, e cila në shtatë vitet e fundit ka grumbulluar rreth 250,000 franga zvicerane. Aktivitetet e kësaj shoqate që nga viti 2009 janë të pasqyruara në adresën e shoqatës në internet [www.17shkurti.ch](http://www.17shkurti.ch).



**FOTO 3:** NJË NGA TAKIMET E SHOQATËS “17 SHKURTI”<sup>8</sup>

## Koretini

Koretini është një ndër fshatrat më të mëdha të rajonit të Gjilanit dhe bën pjesë në Komunën e Kamenicës. Organizimi vetanak i banorëve të këtij fshati dhe diasporës ka filluar relativisht vonë, në mars të 2015. Më 1 mars 2015, diaspora e fshatit Koretin, kryesisht në Zvicër, themeluan shoqatën humanitare “Koretini”. Një nga arsytet e vetëorganizimit ishin problemet e shumta infrastrukturore dhe sociale në fshat dhe mungesa e ndihmës nga komuna.<sup>9</sup>

Aktivistët e shoqatës kanë filluar evidentimin e të gjithë familjeve që ndodhen në diasporë, por sipas përlogaritjeve fillestare besohet se nga ky fshat janë rreth 400 familje me gjithsej 2000 anëtarë që jetojnë jashtë vendit, ku 256 familje janë evidentuar vetëm në Zvicër.

Shoqata “Koretini” ka ndihmuar financiarisht për angazhimin e tre punëtorëve dhe një mbikëqyrësi të punëtorëve. Këta punëtorë, të cilët janë pajisur edhe me kamionetë dhe mjetet tjera përcjellëse

<sup>8</sup> Burimi: <https://www.facebook.com/Vetembanoretemireshit/?fref=ts>

<sup>9</sup> Intervistë me Adhurim Maka – koordinator i punëtorëve të fshatit (intervistë e zhvilluar më 7 mars 2017) dhe Ramadan Basha – aktivist i shoqatës dhe kryetar i klubit të futbollit “Bashkimi” nga Koretini (intervistë e zhvilluar më 8 mars 2017).

të nevojshme për pastrim, kujdesen për pastrimin e shtratit të lumit, pastrimin e varrezave, trotuareve, etj. Punëtorët marrin një pagë mujore prej 287 euro bruto dhe shoqata paguan edhe kontributet pensionale.



**FOTO 4.** PUNËTORËT E FSHATIT KORETINI

Shoqata gjithashtu ka ndihmuar edhe në ri-aktivizimin e klubit “Bashkimi”, i cili bën gara në ligën e dytë të futbollit. Aktivizimi i klubit, së bashku edhe me aktivitetet kulturore që organizohen në kuadër të shkollës së fshatit, ka ndikuar në aktivizimin e rinisë në aktivitete sportive dhe kulturore.



**FOTO 5.** KLUBI I FUTBOLLIT “BASHKIMI”

Për koordinimin e aktiviteteve në fshat, shoqata “Koretini” bashkëpunon me këshillin e fshatit, i cili është zgjedhur me votat e 250 banorëve të fshatit. Kontributet financiare të shoqatës bëhen përmes xhirollogarisë së klubit të futbollit, por aktivistët e këtij fshati janë në proces të regjistrimit të shoqatës si organizatë jo qeveritare.

Të gjitha aktivitetet financohen nga shoqata, por që nga ky vit ka filluar edhe grumbullimi i pagesës nga familjet e fshatit, prej 12 euro në vit. Sipas përfaqësuesve të fshatit, problemet kryesore të hasura deri më tani janë vetëdijesimi i ngadalshëm i banorëve për rëndësinë e kontributeve dhe aktivizimit qytetar, si dhe mos gatëshmëria e komunës për të ndihmuar në këto aktivitete, sidomos në aktivizimin e inspektoratit mjedisor.



Foto 6. ANËTARËT E SHOQATËS “KORETINI” NË ZVICËR<sup>10</sup>

Ndihma e shoqatës dhe organizimi në fshatin Koretin kanë motivuar edhe banorët e së paku dy fshatrave tjera në Komunën e Kamenicës që të vetë organizohen.

## Smira

Smira është fshat në Komunën e Vitisë i cili ka 4,345 banorë, prej të cilëve 3,872 jetojnë në fshat dhe 473 janë banorë jorezident. Me 569 shtëpi të banuara, Smira është vendbanimi i tretë më i madh në komunën e Vitisë për nga numri i banorëve, pas qytetit të Vitisë dhe fshatit Pozheran.

<sup>10</sup> Foto e marrë nga faqja e shoqatës në internet [www.koretini.com](http://www.koretini.com)

Vetëm gjatë katër viteve të fundit, banorët e Smirës kanë zhvilluar mbi 50 projekte dhe aktivitete, ndërsa arkivi i këshillit të fshatit ka evidentuar një vlerë prej 425,000 euro të dhuruara nga vetë qytetarët në 15 vitet e fundit. Këto projekte përfshijnë: shtrimin e rrugëve, ndërtimin e monumenteve historike në fshat, renovimin e shkollës, bursa për studentë, pushime verore për nxënës të dalluar, konkurs për të shpërblyer kopshtin më të mirë familjar në fshat, organizimin e takimeve lamtumirëse për mësues të pensionuar, krijimin e hapësirave të gjelbëruara, aksione pastrimi të mjedisit, aksione solidare në ndërtimin e shtëpive, aktivitete kulturore e sportive, si dhe hapjen dhe mirëmbajtjen e faqes informuese në internet.<sup>11</sup>



**FOTO 7:** BANORËT E FSHATIT SMIRË DUKE NGJYROSUR HYRJEN DHE RRETHOJAT E SHKOLLËS SË FSHATIT (QERSHOR 2016)

Pjesa më e madhe e rrugëve të lagjeve në fshatin Smirë janë asfaltuar me kontribute financiare të banoëve, bizneseve dhe diasporës. Një komision i fshatit, ka shpallur tender publik dhe ka përzgjedhur kompaninë me kushtet më të mira teknike dhe financiare. Rruga e asfaltuar nga “Papenburg&Adriani”, e cila është përzgjedhur nga banorët, është shumë më e qëndrueshme se sa rrugët e shtruara shumë vite më vonë nga komuna”, thotë Afrim Salihu, ish-kryetar i Bashkësisë Lokale të Smirës.

<sup>11</sup> Intervistë me Afrim Salihun - -sh-Kryetar i Bashkësisë lokale në fshatin Smirë. Intervista është zhvilluar me date 16.03.2017.

Me kontribute financiare të komunitetit dhe bizneseve nga ky fshat, nga viti 2005 deri në 2017 janë ndërtuar 11 shtëpi të reja për banorët e fshatit me gjendje më të rëndë ekonomike.

Ndihmë të madhe për këtë fshat kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin komuniteti i Smirës në diasporë. Ky komunitet është i koncentruar kryesisht në Gjenevë të Zvicrës, ku ka themeluar shoqatën “Smira”.



FOTO 8. AKTIVITETI I SHOQATËS “SMIRA” NË ZVICËR<sup>12</sup>

## Stublla e Epërme

Komuniteti i Stubllës së Epërme ka poashtu traditën e organizimit komunitar që nga viti 1990. Karakteristikë e këtij fshati është numri i madh i banorëve që jetojnë në diasporë. Sipas të dhënave të regjistrimit të popullsisë më 2011, në fshat banojnë rreth 1,200 banorë, kurse besohet se 3,000 të tjerë jetojnë në Zvicër, Gjermani, Itali e Austri.

Këshilli i fshatit që ka shtatë anëtarë, i zgjedhur rregullisht përmes zgjedhjeve, ka edhe Këshillin e Përgjithshëm të Stubllës, që përbëhet nga shoqatat e stubllasve në diasporë. Ata kanë planin zhvillimor të fshatit, ku në takimet vjetore diskutojnë punët e realizuara dhe përcaktojnë dinamikën e projekteve të tjera vjetore. Më 2016, takimin vjetor ata e mbajtën në Itali, ku ndër të tjera u diskutua edhe ndërtimi i shtëpisë së të moshuarve në Stubëll. Kjo ka dalë si nevojë e komunitetit, sepse përveç disa

<sup>12</sup> Foto e marrë nga faqja e fshatit në internet [www.fshatismire.com](http://www.fshatismire.com) (qasur më 16.3.2017).

banorëve që kanë nevojë për përkujdesje, një numër i bashkëvendasve që jetojnë jashtë, duan që pjesën e fundit të jetës ta kalojnë në vendlindje.



**FOTO 9.** TAKIMI I SHOQATAVE TË DIASPORËS DHE KËSHILLIT TË FSHATIT MË 11 MARS 2017 NË STUBËLL

Në 16 vitet e fundit, sipas përfaqësuesve të fshatit, në Stubëll të Epërme janë realizuar projekte në vlerë prej mbi 1 milion euro. Kanë qenë këto projekte si: renovimi i shkollës, përforcimi i rrjetit elektrik, ndriçimi i rrugës kryesore, asfaltimi i rrugëve dytësore, ndërtimi i shtëpive solidare, ambulancës, qendrës rinore, sheshi i fshatit, muzeu i shkollës së parë shqipe, ndërtimi i Rrugës së Kryqit (si monument fetar), organizimi për 25 vite i Ditëve të Dom Mikel Tarabulluzit.

Stublla ka krijuar marrëdhënie binjakëzimi me qytezën e Jennersdorfit në Austri, duke shkëmbyer përvojat dhe aktivitetet kulturore. Ndërkaq, të vetmet fonde nga donatorë të huaj fshati ka përfituar tri projekte bujqësore nga qeveria komunale e Tirolit të Austrisë.

Rrregullorja e Këshillit të Përgjithshëm të Stubllës është një dokument shumë më substancial se shumë dokumente tjera zyrtare. Këshilli i Stubllës ka edhe fondin emergjent prej afro 50,000 euro, që shpesh vendos t'u ndihmojë bashkëvendasve në nevoja të ndryshme individuale. Këshilli ka xhirollogarinë e vet, vulën dhe gjithë dokumentacionin e të gjitha projekteve të realizuara deri më tash në fshat.

Në Stubëll, vetë komuniteti kryen shërbimet e mirëmbajtjes dimërore të rrugëve dytësore, ndërkaj një punëtor kujdeset për mirëmbajtjen e varrezave të fshatit dhe grumbullimin e mbeturinave të amvisërisë.

Në planin zhvillimor deri më 2018, Këshilli i Stubllës planifikon instalimin e rrjetit të ujësjellësit, të cilin nuk e kanë ende, ndërtimin e një rruge alternative kryesore të fshatit, ndërtimin e objektit të Këshillit, ndërtimin e shtëpisë së pleqve, ndriçimin e rrugëve deri në çdo shtëpi dhe ndërtimin e trotuareve.



FOTO 10. FSHATI STUBËLL E EPËRME

## Lubinja e Epërme

Ky fshat i banuar nga 2,000 banorë të komunitetit boshnjak ka ndërtuar një sistem të mirëfilltë të organizimit komunitar, me një administratë pothuajse të nivelit komunal. Rreth 600 shtëpi kontribuojnë me vetëfinancim për organizimin e jetës komunitare, duke paguar nga 0.50 euro/cent për çdo anëtar të familjes, ndërsa kontributi i diasporës është i vazhdueshëm. Ata janë aktiv me shoqatat e tyre në Zvicër, Gjermani, Itali, e vendet

skandinave, ndërsa kanë fondin e tyre të veçantë përmes të cilit kontribuojnë për vendlindjen e tyre.<sup>13</sup>

Këshilli i Fshatit, ndonëse është zgjedhur përmes rregullores komunale, ai ka një strukturë më të gjërë dhe unike. Kuvendi i Bashkësisë Lokale, është organi vendimmarrës, ku nga 6 lagje të fshatit, janë 29 anëtarë që e përbëjnë Kuvendin. Ndërkaq, mbarëvajtjen e organizimit e bëjnë 7 komisionet: për ujësjellës, rrugë, shërbime komunitare, për çështje juridike, financa, çështje teknike dhe komisioni për sport dhe kulturë.



**Foto 11.** FSHATI LUBINJË E EPËRME

Bashkësia Lokale e Lubinjes së Epërme punëson 6 punëtorë, përfshirë sekretarin, zyrtarin financiar, zyrtarin për çështje juridike, dhe punëtorët për mirëmbajtjen e ujësjellësit, rrugëve, ndriçimit publik dhe grumbullimit të mbeturinave. Rrogat e tyre mujore janë nga 50-200 euro.

Bashkësia ka rregulloren e vetë të punës, një dokument që përcakton gjithë mënyrën e organizimit, ndërsa dokumentet tjera si rregullorja e participimit financiar diskutohet dhe aprovet

<sup>13</sup> Intervistë me Ibra Shaqir, kryetar i Bashkësisë Lokale Lubinje e Epërme, 26 mars 2016



çdo vit në Kuvend. Po ashtu, çdo vit Bashkësia Lokale hap konkursin për 6 pozitat e punës për punëtorët e vet. Çdo kërkesë e banorëve apo një individ duhet të bëhet me shkrim në administratën e Bashkësisë dhe paguhet taksa prej 2 euro për protokolim, e cila kërkesë shqyrtohet brenda dy javësh.

Nga dokumentet e prezentuara nga kryetari dhe zyrtari financiar, shihet qartë ky rregullim komunitar. Në vitin 2015, inkasimi për participim të komunitetit ishte 60%, gjersa në vitet paraprake (2012) ishte deri në 90.4%. Kështu, gjatë 2015, Bashkësia Lokale e Lubinjës së Epërme kishte mbledhur 13,241 euro nga participimi për kokë banori, si dhe 3,705 euro të hyra të tjera nga inventari i fshatit, i cili u jepet në shfrytëzim banorëve për organizimin e dasmave dhe ahengjeve.



**FOTO 12.** FSHATI LUBINJË

## Karakteristikat e përbashkëta të lokaliteteve të vetëorganizuara

Gjashtë lokalitetet e përshkruara më sipër ndodhen në komuna të ndryshme të Kosovës. Në shikim të parë duken lokalitete shumë të ndryshme, por kanë disa të përbashkëta, të cilat besojmë se kanë ndikuar në vetë organizim. Pjesa më e madhe e këtyre lokaliteteve janë fshatra relativisht të mëdha për nga numri i banorëve, në krahasim me popullsinë mesatare të fshatrave në Kosovë, e cila sipas regjistrimit të popullsisë më 2011 është rreth 833 banorë për fshat.

Ajo çfarë bie në sy është numri i madh i atyre që jetojnë në diasporë, kryesisht në Zvicër, dhe të cilët janë të mirëorganizuar. Ekziston një përshtypje se diaspora ka pushuar aktivitetin e saj politik dhe financiar dhe që nga pas lufta ndihma kryesore e diasporës është reduktuar vetëm në ndihmën financiare për familjet e tyre në Kosovë. Shembujt e lartcekur dëshmojnë se një pjesë e diasporës vazhdon të jap kontribut në organizimin komunitar. Përveç organizimit në formë të shoqatave në diasporë, ata kanë pasur ndikim të madh edhe në organizimin e bashkëvendësve të tyre në Kosovë.

Në organizimin e këtyre fshatrave, rol të rëndësishëm luan edhe ndihma e bizneseve të mëdha nga këto lokalitete. “Papenburg & Adriani” është një ndër bizneset më të mëdha në Kosovë për shtrimin e rrugëve dhe një pjesë të aktivitetit e ushtron edhe në Zvicër. Pronarët e biznesit kanë ndihmuar në ngritjen e klubit “Bashkimi” në Koretin, si dhe kanë ndihmuar financiarisht në aktivitetet tjera të fshatit. Njësoj, “Elektro Stublla” ka ndarë me mijëra euro përgjatë këtyre viteve për projekte të përbashkëta në fshatin Stubëll e Epërme. “Migros” është biznes i suksesshëm i prodhimit të orendive dhe ka dhënë ndihmë të madhe në projektet e fshatit Smirë.

Në të gjitha këto lokalitete, organizimi qytetar kryesisht manifestohet në projekte që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e hapësirave të përbashkëta, rritjen e hapësirave gjelbëruese, pastrimin e varrezave, shtretërve të lumenjve dhe ndërtimin e shtëpive për familjet me gjendje më të rëndë sociale.

TABELA 1: TË DHËNA BAZIKE PËR LOKALITETET E VETËORGANIZUARA

Emri i vendbanimit	Dobërçan (Miresh)	Koretin	Lubinje e Epërme	Korishë	Smirë	Stubëll
Komuna	Gjilan	Kamenicë	Prizren	Prizren	Viti	Viti
Banorë (bashkë me diasporë)	2,700	3,500	3,200	5,300	4,345	1,200
Diasporë		2,000				3,000
Fillet e vetëorganizimit	Që nga pas lufta, në formë më të strukturuar që nga shkurti i vitit 2009	Që nga muaji mars 2015	?	Që nga pas lufta	Vazhdimësi e aktiviteteve që nga vitet '90	Vazhdimësi e aktiviteteve që nga vitet '90
Forma e organizimit	Shoqatë e cila aktivitetin më të madh e ka në Zurich të Zvicres, ka statutin e saj. Nuk është e regjistruar si OJQ në Kosovë	Shoqatë e cila aktivitetin më të madh e ka në Zvicër. Nuk është e regjistruar si OJQ në Kosovë.	Bashkësi Lokale, e zgjedhur sipas rregullave me Statutin e Komunës së Prizrenit, por me një strukturë të veçantë, me Kuvend prej 29 anëtarësh.	Bashkësi Lokale	Bashkësi Lokale	Bashkësi Lokale në bashkëpunim me shoqatat "Stublla" në Itali, Zvicër, Austri dhe Gjermani.
Kontributet financiare vjetore	10 euro banorët e fshatit 20 euro bizneset 50 franga zvicerane diaspora	12 euro banorët e fshatit;	50 cent në muaj për çdo anëtar të familjes;	3 euro në muaj për secilën familje	Participim sipas thirrjeve për të ndihmuar në infrastrukture dhe ndërtim të shtëpive për familjet në nevojë	Fondi emergjent vjetor prej 50,000 euro.
Aktivitetet kryesore	- vendosja e shportave për mbeturina, - mirëmbajtja e shtratit të lumit dhe	-vendosja e shportave për mbeturina, - mirëmbajtja e shtratit të lumit	- mirëmbajtja e ujësjellësit; - grumbullimi i mbeturinave. - kujdesi për	- pastrimin e rrugëve të fshatit, - eliminimin e defekteve të kanalizimit,	- ndërtim të shtëpive të banimit për familje; - asfaltim të rrugëve të lagjeve;	- renovimi i shkollës, - përforcimi i rrjetit elektrik, - ndriçimi i rrugës kryesore,

	varrezave, - mbjellja e luleve dhe drunjve dekorativ, - ndërtimi i kamp-shtëpizës për aktivitetet rekreative të banorëve, - ndihma për familjet në nevojë, - mirëmbajtja e parkut të fshatit	dhe varrezave, - ndihma për familjet në nevojë, - mirëmbajtja e fushës së futbollit dhe ndihma financiare për klubin e futbollit “Bashkimi”	ndriçimin publik;	- mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit, - hapjen e vijave për ujitjen e tokave pjellore, - pastrimin e varrezave.	- pastrimi i varrezave dhe largimi i deponive të bërlllogut; - mirëmbajtja e hapësirave të shkollës; - organizimi i aktiviteteve kulturore.	- asfaltimi i rrugëve dytësore, - ndërtimi i shtëpive solidare, ambulancës, qendrës rinore, sheshi i fshatit, muzeu i shkollës së parë shqipe,
Ndihma e bizneseve	Fshati ka biznese të vogla, pro të cilat kontribuojnë nga 20 euro në vit.	Një ndër bizneset më të mëdha e cila ka ndihmuar është kompania “Papenburg & Adriani”.			Një ndër bizneset më të mëdha e cila ka ndihmuar është kompania “Migros”.	Një nga bizneset që ka kontribuar më së shumti në këtë fshat është “Elektro-Stublla”
Angazhimi i diasporës	Diaspora e përqëndruar kryesisht në Zvicër	Diaspora e organizuar në Zvicër	Diaspora e organizuar në Gjermani, Zvicër, Itali, vendet skandinave.	-	Diaspora e përqëndruar kryesisht në Zvicër	Diaspora e organizuar në Itali, Zvicër, Gjermani, Austri.
Mënyrat e informimit	Faqja zyrtare në internet <a href="http://www.17shkurti.ch">www.17shkurti.ch</a> Faqja në facebook: “Vetem banorët e Mireshit”	Faqja zyrtare në internet <a href="http://www.koretini.com">www.koretini.com</a> Faqja në facebook: “Koretini-vendlindja jonë”	/	/	Faqja zyrtare në internet <a href="http://www.fshatismire.com">www.fshatismire.com</a> Faqja në facebook: “Fshati Smirë”	Grup në facebook “SH-I-H-K STUBLLA.

## Përfundim

Aktivizmi qytetar është një ndër mënyrat më efektive për të garantuar funksionimin e drejtë të një sistemi demokratik qeverisës. Aktivizmi qytetar mund të mbështetet nga institucionet publike në nivel lokal apo qendror, ose të veprojë i shkëputur dhe pa ndonjë ndërlidhje me institucionet qeverisëse. Aktivizmi qytetar mund të fillojë nga pastrimi i një rruge të lagjes, zgjerimi i hapësirave gjelbëruese, e deri tek propozimi i politikave në nivel lokal apo qendror.

Gjatë viteve të '90-ta, të përjashtuar nga çdo institucion shtetëror, duke ua mohuar shkollimin në gjuhën shqipe dhe shërimin në objektet publike spitalore, kosovarët u organizuan në shoqata dhe grupe jo formale, duke ndërmarrë aksione të përbashkëta për shtrimin e rrugëve, kthimin e shtëpive private në objekte shkollore, ndërtim të shtëpive të banimit për familjet me gjendje më të rëndë ekonomike, e deri tek krijimi i fondeve buxhetore, për organizimin e qeverisë paralele, shkollave, ndihmave sociale, etj.

Me mbarimin e luftës dhe krijimin e institucioneve vetëqeverisëse, u krijua një bindje e gabuar se institucionet e zgjedhura do të arrijnë të mbulojnë të gjitha detyrimet publike. Ky besim i gabuar bëri që në masë të madhe, qytetarët të mos angazhohen në punët publike. Hulumtimi i Institutit GAP tregon se kosovarët në masë të madhe nuk angazhohen në punë vullnetare (85%), nuk janë pjesë e ndonjë organizate jo qeveritare (96%), nuk janë anëtarë të partive politike (82%) dhe nuk marrin pjesë në takimet publike që organizojnë komunat (81%).

Por, së paku gjashtë vendbanime të identifikuara nga Instituti GAP bëjnë përjashtim nga ky rregull. Korisha, Doberqani, Koretini, Smira, Stublla e Epërme dhe Lubinja e Epërme, janë shembuj të mirë të aktivizmit qytetar. Me vetë iniciativë dhe kontribut financiar, banorët e këtyre lokaliteteve mbulojnë shërbime të cilat nga shumica e popullsisë konsiderohen obligime vetëm të komunës apo qeverisë.

Me qëllim të rritjes së aktivizimit qytetar dhe shembujve të tillë si gjashtë lokalitetet e lartpërmendura, Instituti GAP do të ndërmarrë një fushatë të gjerë informuese ku do të ndajë këta gjashtë shembuj edhe me lokalitete të tjera në Kosovë.

Po ashtu, Instituti GAP rekomandon:

- Komunitetet e organizuara të regjistrohen si shoqata konform Ligjit për lirinë e asociimit në organizata jo qeveritare.** Përkundër asaj se komunitetet e përfshira në këtë raport funksionojnë si shoqata, madje shumica prej tyre kanë edhe statutet e tyre, ato nuk janë të regjistruara si shoqata në Ministrinë e Administratës Publike. Regjistrimi si shoqata do lehtësonte organizimin, financimin dhe raportimin. Thuajse të gjitha lokalitetet e përshkruara në këtë raport kanë xhirollogari e cila i takon personave fizik apo edhe klubeve të futbollit, në të cilat deponohen kontributet financiare dhe nga të cilat kryhen pagesat. Regjistrimi formal si shoqata do t'ua mundësonte hapjen e xhirollogarive bankare, në të cilat do të mund të kontribuonin edhe organizata donatore.
- Komuna t'u asistojë lokaliteteve të vetëorganizuara.** Përkundër asaj se lokalitet e përshkruara në këtë raport janë të vetëdijshme për kufizimet buxhetore që kanë komunat, ato kërkojnë që së paku komunat të kryejnë detyrat e tyre që kanë të bëjnë me inspektimet. Duke marr parasysh se komunitetet e vetëorganizuara nuk janë edhe organe zbatuese të ligjit, nevojitet intervenimi i institucioneve në rastet kur puna e komunitetit dëmtohet nga persona të papërgjegjshëm. Ndihmë tjetër që mund të japin komunat janë asistimi në projekte të mëdha, si ujësjellësi apo rrjeti i kanalizimit, të cilat janë projekte më komplekse për t'u realizuar dhe duhet të përputhen me planin zhvillimor lokal.
- Donatorët të përkrahin organizimet komunitare.** Që nga viti 1999 shoqëria civile në Kosovë është mbështetur me qindra miliona euro nga donatorët ndërkombëtarë. Por për shkak të procedurave për aplikim dhe formës së organizimit të komuniteteve në Kosovë, kjo kategori e shoqërisë civile nuk ka gjetur mbështetjen e donatorëve. Me qëllim të inkurajimit të organizimit komunitar, donatorët duhet të mbështesin nisma të tilla qytetare.
- Angazhimi i diasporës.** Përkundër besimit të përhapur se pas vitit 1999 ndihma e diasporës është kufizuar vetëm në ndihmën financiare për familjet, shembujt në këtë raport tregojnë se diaspora jep ndihmë të madhe në organizimin komunitar. Ky është një shembull që mund të ndiqet edhe nga lokalitete nëpër Kosovë. Përveç ndihmës financiare, komunitetet në Kosovë mund të përfitojnë edhe nga përvojat e diasporës në vendet tjera më të zhvilluara.

Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Instituti GAP mbështetet nga:



**Rockefeller  
Brothers Fund**

Philanthropy for an Interdependent World

Ky raport është mbështetur nga:



**National Endowment  
for Democracy**

*Supporting freedom around the world*